




UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE

2043
16 12



Nr. 7 Prot

Datë: 13.12.2024

Lënda: Kërkesë për publikim në faqen zyrtare

**DREJTORISË SË KOMUNIKIMIT DHE BURIMEVE NJERËZORE TË
UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE.
Znj. ELOINA TOZAJ**

Në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; në mbështetje të nenit 7 të "Rregullores për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë", miratuar me Vendimi të Senatit Akademik Nr.11, datë 21.03.2024; bashkëngjitur po ju përcjell **Vendimin Nr.1 të datës 13.12.2024 "PËR HAPJEN E PROCESIT TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE PËR DREJTUES TË NJËSISË BAZË, PËR ANËTARËT E KOMISIONEVE TË DHËNIES SË GRADËS SHKENCORE "DOKTOR" NË NJËSINË KRYESORE NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI" VLORE".**

Duke ju falenderuar për bashkpunimin.

**Kryetar i Komisionit Zgjedhor i Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore
Dr. Alma Sheko**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE



Nr.6 Prot

Datë, 13./12./2024

NJOFTIM

PËR HAPJEN E PROCESIT TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE PËR DREJTUES TË NJËSISË BAZË, PËR ANËTARËT E KOMISIONEVE TË DHËNIES SË GRADËS "DOKTOR" NË NJËSINË KRYESORE NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI" VLORË

Në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; Vendimit të senatit akademik Nr.11, datë 21.03.2024 "Për miratimin e Rregullores për organizmin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë", bazuar në nenin 25; në zbatim të nenit 22, pika 6 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali"; Vendimit të Komisionit Zgjedhor të Fakultetit Nr.1, datë 13.12.2024 "Për hapjen e procesit të regjistrimit të kandidatëve për Drejtues të Njesisë Bazë, për Anëtarët e Komisioneve të dhënies së gradës shkencore "Doktor" në Njesisë Kryesore në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore".

Kërkesa për kandidim nga personat e interesuar depozitohet nga kandidati në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore, kati i tretë, godina C, nga data 16.12.2024, deri në datën 20.12.2024, brenda orarit zyrtar 8:00-16:00.

I - Kandidatët për Drejtues të Njesisë Bazë duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm.

- a) Kërkesa për kandidim, e cila përmban emrin, atësinë; mbiemrin; datëlindjen; gjininë dhe shprehjen e vullnetit për kandidim;
- b) Kopje të dokumentit të identifikimit;
- c) Formularët e vetëdeklarimit, të cilët kandidati i tërheq pranë KZF FSHTN;
 - i. Deklarimin se kandidati nuk ka fituar dy mandate sipas ligjit nr.9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në RSH", si autoritet drejtues në postin për të cilin kërkon të kandidojë në të njëjtin institucion;
 - ii. Deklarimin e mungesës së plagjiaturës në punimet për fitimin e gradës shkencore dhe titullit akademik;
 - iii. Deklarimin se nuk ka shkak për të qenë objekt i ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";
 - iv. Deklarimin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale.
 - v. Deklarimin për neutralitetin politik, mosqenien pjesë e forumeve të larta politike në vend.



REPUBLIKA E SHqipërisë

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE



II - Kandidatët për Anëtar të dhënies së gradës Shkencore "Doktor" duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm

- a) Kërkesa për kandidim, e cila përmban emrin, atësinë; mbiemrin; datëlindjen; gjininë dhe shprehjen e vullnetit për kandidim;
- b) Kopje të dokumentit të identifikimit;
- c) Formularët e vetëdeklarimit, të cilët kandidati i tërheq pranë KZF FSHTN;
 - i. Deklarimin e mungesës së plagjiaturës në punimet për fitimin e gradës shkencore dhe titullit akademik;
 - ii. Deklarimin se nuk ka shkak për të qenë objekt i ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";
 - iii. Deklarimin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale.
 - iv. Deklarimin për neutralitetin politik, mosqenien pjesë e forumeve të larta politike në vend.

Kryetar i Komisionit Zgjedhor i Fakultetit

Dr. Alma Sheko

ANËTARËT:

Eni Meli

Kristiana Veshaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE



Nr. 5 Prot

Datë, 13.12.2024

VENDIM
Nr. 1, datë 13.12.2024

PËR HAPJEN E PROCESIT TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE PËR DREJTUES TË NJËSISË BAZË, PËR ANËTARËT E KOMISIONEVE TË DHËNIES SË GRADËS "DOKTOR" NË NJËSINË KRYESORE NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI" VLORE

Në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; në zbatim të nenit 7 pika 6/d, nenit 18 pika 3 të vendimit të Senatit Akademik nr. 11, datë 21.03.2024 "Për miratimin e Rregullores për organizmin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë"; në zbatim të nenit 22, pika 6 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali".

Komisioni Zgjedhor i Fakultetit, në mbledhjen e datës 13.12.2024

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e procesit të regjistrimit të kandidatëve për Drejtues të Njesisë Kryesore, per Departamentin e Matematikës dhe Fizikës dhe Departamentin e Shkencave Detare, për Anëtarët e Komisioneve të dhënies së gradës shkencore "Doktor" në Njësinë Kryesore në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.
2. Të miratojë periudhën kohore të regjistrimit të kandidatëve datën 16.12.2024, deri në datën 20.12.2024, brenda orarit zyrtar 08:00-16:00.
3. Procesi i regjistrimit kryhet kur kandidati paraqitet personalisht në zyrën e Komisionit Zgjedhor të Fakultetit për të depozituar dokumentacionin për kandidim.
4. Pas regjistrimit, kandidati i jepet vërtetimi i regjistrimit si kandidat nga Komisioni Zgjedhor i Fakultetit.
5. Vendimi publikohet në të gjitha mjediset e Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore në Universitetin "Ismail Qemali" dhe në sitin zyrtar www.univlora.edu.al.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar i Komisionit Zgjedhor i Fakultetit
Dr. Alma Sheko

ANËTARËT:

Eni Meli

Kristiana Veshaj